REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 132/17
Datë/Datum. 18.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Spitali i Përgjithshëm-Gjilan**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.132/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me reagenca për Olimpus" Lot 1,** me nr. prokurimi: **702/17/04/121**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE N.T.P "Buli Medical"-Prishtinë**		
Datë	**18.05.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me reagenca për Olimpus - Lot 1",** me nr. prokurimi:**702/17/04/121,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Spitali i Përgjithshem-Gjilan,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **OE N.T.P "Buli Medical"-Prishtinë,** me nr.prot.**132/17,** e datës 04.05.2017

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		10.05.2017		11.05.2017		18.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 04.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 132/17, e parashtruar nga operatori ekonomik: N.T.P "Buli Medical"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me reagenca për Olimpus - Lot 1", me nr. prokurimi: 702/17/04/121, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Spitali i Përgjithshem Gjilan.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues:* ***N.T.P " Buli Medical"-Prishtinë***

Neni 6 i LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti).

Neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi).

Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).

Neni 108/A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve).

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Me date: 28.04.2017 me ane të kërkesës për rishqyrtim, kemi kërkuar nga AK- Spiali Regjional -Gjilan që: "Kërkojme nga AK-ja Spitali i Përgjithshem- Gjilan, që konform Nenit 108/A, ta bëjë pezullimin e anulimit dhe të nxjerrë vendim mbi aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim të vendimit të AK-së".

AK-ja Spiali Regjional-Gjilan, fillimisht duke e bërë shkeljen e Nenit 108/A, duke mos e bërë pezullimin e këtij aktiviteti të prokurimit, gjithashtu duke e shkeluur Nenin 59 të LPP-së, na njofton fillimisht me ane të Letres standarte për Tenderuesin e pasukseshem se oferta e jonë e tejkalon buxhetin e parapare në dispozicion prej 60.000.00 euro. Pas marrjes së kësaj letre , ne si ofertues kemi kërkuar qasje në dokumentet e tenderit, me çrast kemi vërejtur se Zyrtari i Prokurimit e ka marre këtë vendim në kundërshtim me rekomandimin e komisionit të vlerësimit të ofertave. Sipas llogaritjes se ofertes nga komisioni del se oferta e jonë e ka çmimin 18.276.92 euro. - - Nese i referoheni Dosjes se Tenderit, përkatesisht Pjeses C tek pershkrimi i çmimeve, aty kërkohet qe çmimi te jipet për ml, ku paketimi ka qenë i përcaktuar nga AK-ja. (paketimi në ml). AK- konkretisht Zyrtari i Prokurimit (edhe pse i ka pranuar te gjitha spjegimet qe i ka kërkuar nga ne, në forme të shkruar), ne spjegimin e tij, thot se llogaritja është bërë përmes kodeve të reagjenteve, qe sipas nesh dicka e tillë eshte e pamundur, sepse kodi i produktit nuk ka kurrfar lidhje me llogaritjen e çmimit final të ofertes. Ne si perfaqesues te produkteve te OLYMPUS nuk e kemi te qarte se si po u bejka llogaritje me ane te kodit. Kerkojme nga

OSHP,qe ta obligoje AK-në qe ta beje rivlersimin e ofertave dhe qe te kihen parasysh te gjitha kerkesat e DT ashtu sic vet i ka caktuar AK-ja dhe qe ta beje vleresimin e ofertes tone ashtu sic e parasheh Neni 59 i LPP-së.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....15.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....Procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Furnizim/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 09.03.2017

Data e hapjes së ofertave (N.58):.....09.03.2017-ora 12:00h
Data e njoftimit për anulim.....25.04.2017
Kriter për dhënien e kontratës.....Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	LOT	Çmimi	Vëretje
1	NTP AL - PLAST	GJILAN	I	22,324.42€	JO
2	BIOTEK KOSOVO	PRISHTINË	I	42,667.32€	JO
3	NTP BIOLAB	GJILAN	I	27,620.14€	JO
4	BULI MEDICAL	PRISHTINË	I	212.63€	JO
5	INTERLAB sh.p.k	DAVIDOVC	I	42,130.34€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë për LOT-1, pesë (5) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjes e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
KERKESA 1. Operatori Ekonomik duhet te permbushe kerkesat e specifikuara ne nenin 65 te ligjit per, Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L- 092 për Prokurimin Publik në Kosovë, gazeta zyrtare Nr.08 të dt.01.03.2016 ,munde te shkarkohet nga faqe e internetit krpp.rks-gov.net
EVIDENCA NGA FITUESI I TENDERIT Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise para shperblimit te kontrates janë me se vijon: -Për situaten referuar nenit 65,paragrafi3 ,nenparagrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4,nen-paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.4,vertetim i leshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative te vendit te themelimit te tenderuesit.

4.-Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore e vendit te themelimit te operatorit ekonomik ,se operatori ekonomik ne fjale nuk eshte delikuent (shkeles)ne pagesen e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit te vitit para dates se publikimit te Njoftimit te Kontrates. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
EVIDENCA 1. Nje deklarata e shkruar nen Betim,e nenshkruar nga tenderuesi duke perdorur formen e percaktuar ne dosjen e tenderit. Per qdo OE nese jane Grup i OE EVIDENCA NGA FITUESI I TENDERIT Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise para shperblimit te kontrates janë me se vijon: -Për situaten referuar nenit 65,paragrafi3 ,nenparagrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4,nen-paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.4,vertetim i leshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative te vendit te themelimit te tenderuesi
Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore e vendit te themelimit te operatorit ekonomik ,se operatori ekonomik ne fjale nuk eshte delikuent (shkeles)ne pagesen e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit te vitit para dates se publikimit te Njoftimit te Kontrates. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
KERKESA.
Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.
KERKESA . Regjistrimi i TVSH.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
EVIDENCA Nje dokument leshuar nga autoriteti perkates publik ne vendin e themelimit te operatorit ekonomik mete cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik ne ate vend (Kopja e certifikates se biznesit)– per qdo OE nese jane Grup i OE EVIDENCA Kopja e TVSH-se –per qdo OE nese jane Grup i OE

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
KERKESA - Katalogu i nënvizuar per secilin lloj te reagences.

KERKESA – Kualiteti i reagencave duhet te jete te qertifikuar sipas standardeve ISO –CE, certifikata ISO, CE certivak.

KERKESA - Autorizimi per shitje dhe servisim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar per reagjentet e ofruar- origjinal apo kopje noterizuar.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Behar UKA: Kryesues,
Shpresa RAMIQI: Anëtar,
Ejup ALIU; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 25.04.2017.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësues ka bërë vlerësimin e ofertave në raportin e vlerësimit duke vendosur në rubrikat e kërkesave për secilin operator ekonomik pjesëmarrës por NUK ka dhënë REKOMANDIM me rubriken e raportit të vlerësimit, poashtu në bazë të fletave të punës gjatë kalkulimit të ofertes financiare të OE ankues, ka paraqitur shumën e ofertës për LOT-1 të OE ankues në vlerë prej 18,276.92€.

Zyrtari kryesor i prokurimit ka bërë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit për LOT-1 duke paraqitur arsyetimin në raportin e vlerësimit si në vijim: se të gjitha ofertat e përgjegjshme tejkalojn buxhetin e parapar për këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat për furnizim, vlerë e mesme, e ndarë në lote, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët".

I pakënaqur me njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit LOT-1, të datës 25.04.2017, për këtë aktivitet të prokurimit Lot-1, OE ankues "Buli Medical" - Prishtinë, fillimisht ka parashtruar ankesë në Autoritet kontraktues, dhe pastaj duke parashtruar ankesë edhe në OSHP me datë 04.05.2017, me pretendim ankimor se nuk është respektuar:
Neni 6 i LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti).

Neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi).

Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).

Neni 108/A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve).
Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në

vijim:

Pretendimi ankimor nr.1

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 108/A të LPP-së, Eksperti shqyrtues vlerëson se në rastin konkret Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A, pika 2 dhe 6 të LPP-së, për faktin se i njëjti AK-ja është i obliguar të pezulloj aktivitetin e prokurimit si dhe të shqyrtoj kërkesën për ri-shqyrtim të vendimit të AK-së në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar nga ankimuesi, në rastin konkret Autoriteti kontraktues NUK ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk është përgjigjur në kërkesën për ri-shqurtimin të vendimit të parashtruar nga ana e OE ankues.

Pretendimi ankimor nr.2

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 6,7 dhe 59 të LPP-së, konkretisht kalkumit të çmimit për njësi në ofertën financiare të OE ankues,

Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit të ofertave NUK ka vepruar në harmoni me nenin 59, paragrafi 4, të LPP-së, duke u bazuar në atë se OE ankues ka ofruar ofertën financiare sipas paramasës (përshkrimit të çmimit) të paraqitur në dosjen e tenderit faqe 47,48 dhe 49 për LOT-1), duke konstatuar se në tabel është kërkuar përshkrimi i çmimit për ml, dhe jo siç pretendon AK-ja për kod të produktit, duke u bazuar në këtë Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor i parashtruar nga ana e OE ankues dhe njëherit NUK qëndron arsyetimi i dhënë nga ana e AK-së në lidhje me këtë.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të bazuar, ankesën e OE ankues NTP "Buli Medical", me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit LOT-1, dhe njëherit të kthehet në RI-VLERËSIM, këtë aktivitet të prokurimit: "Furnizim me reagenca për Olimpus-Lot 1", me nr. prokurimi: 702/-17-164-121", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali përgjithshem Gjilan.